



### Kontakti

#### **Spitali Universitar MAS**

Vebadresa: <http://www.umas.se>

e-posta: [umas@skane.se](mailto:umas@skane.se)

Telefoni: 040-33 10 00

Adresa postare: Universitetssjukhuset MAS, 205 02 Malmö

### Nëse sëmuresh...

**E hënë – e premte ora 08.00 – 17.00, kontakto një ambulancë/njësi pranuese të mjekut familjar.**

Nëse nuk je i/e sigurtë se cilës ambulancë/njësi pranuese të mjekut familjar i takon, atëherë i telefono informatës së kujdesit mjekësor, telefoni 1177. Informata e kujdesit mjekësor është hapur ditën dhe natën, dhe poashtu jep këshilla mbi kujdesin vetjak si dhe këshilla mjekësore.

### Kohën tjetër

Nëse ke nevojë për vizitë urgjente, atëherë kur ambulanca/njësia pranuese e mjekut familjar është mbyllur, i telefono informatës së kujdesit mjekësor, telefoni 1177, për ndihmë të vizitës eventuale në Ambulancën e mjekut kujdestar, Ahlmansgatan 12, Malmö.

**Në rast urgjent, gjendje rreziku për jetë  
telefono 112**

### Ndihmesa e përkthyesit

Nëse nuk e flet ose nuk e kupton suedishten, ose nëse i ke të dëmtuara aftësitë e të dëgjuarit ose të të folurit, ke të drejtë në ndihmesën e përkthyesit, atëherë kur ti ke kontakt me mjekësinë. Ua thuaj atyre kur ta porositësh kohën se ke nevojë për përkthyes. Përkthyesi e ka për detyrë vetëm të përkthejë dhe ai/ajo duhet ta ruaj fshehtësinë zyrtare.

## **Synimi dhe detyra**

Takimi personal është në qendër të vëmendjes. Detyra jonë është, që ne së bashku me ty si pacient dhe me të afërmit tu familjar, ta luftojmë sëmundjen dhe shëndetin e lig, në një mënyrë individuale dhe njerëzore.

Ne synojmë që të jemi në ballë të hulumtimeve dhe trajtimit/mjekimit. Synimi ynë është që ta shtojmë pjesëmarrjen e pacientit dhe ndikimin e tij në mjekësinë. Për arritjen e këtij synimi, është kjo një mënyrë, si për ne ashtu edhe për pacientin, që në mënyrë aktive të stimulojmë në mësimin e gjërave,.

## **Një ditë në Spitalin Universitar MAS**

Spitali Universitar MAS, (UMAS), është një spital universitar dhe regional, që ofron mjekim themelor dhe mjekim të specializimit të lartë për 270 000 qytetarë të Malmös dhe për tërë regjionin e kujdesit shëndetësor të jugut ku përfshinë rreth 1,6 milion banorë.

Mesatarisht vizitojnë spitalin UMAS 3 000 pacientë në ditë, 170 prej tyre kërkojnë mjekim urgjent, 50 persona transportohen me ndihmën e shpejtë për në urgjencë, 980 persona janë pacientë të shtrirë, 600 fotografohen në rëntgen, dhe në sallat e operacionit të spitalit kryhen 90 operacione. Mbi 500 mjekë dhe studentë të mjekësisë aftësohen/shkollohen. Centrali telefonik pranon 16 000 telefonata, si dhe në repartin e lindjes lindin 10 fëmijë.

## **Organizata**

UMAS është një spital i urgjencës dhe spital universitar i profiluar sipas nevojës së një qyteti të madh. Ne jemi rreth 7000 të punësuar të klasifikuar në qindra kategori të ndryshme. Pesë grupet profesionale më të mëdha janë përafërsisht 2000 infermierë, 1800 nën infermierë, 860 mjekë, 530 sekretarë mjeku dhe 310 analistë bio-mjekësor.

Spitali Universitar është i organizuar në gjashtë lëmi kryesore:

- Lëmin e urgjencës
- Lëmin e mjekësisë
- Lëmin e kirurgjisë rekonstruktive
- Lëmin e fëmijëve, urologjisë dhe mjekësisë së grave
- Lëmin e psikiatrisë
- Lëmin e mjekësisë laboratorike.

## **Hulumtimi dhe shkollimi**

UMAS gjatë viteve ka qenë i privilegjuar të ketë në gjirin e vet shumë shkencëtarë të njohur, mjekë të aftë e bashkëpunëtorë të devotshëm. Si njëra nga spitalet prijëse universitare të Suedisë, zhvillon hulumtime të shumta dhe shkollim të udhëhequr nga 50 profesorë.

Spitali Universitar MAS është ndër të parat në botë në shumë lëmi, në mes tjerash si në hulumtim dhe kurim të sëmundjes *hemofili* dhe diabetikut. Përveç kësaj, këtu bëhen ndërhyrje të avancuara plastiko-kirurgjike në duar dhe shpinë.

Njësia socialo-mjekësore është njëra nga qendrat më të mëdha Nordike e hulumtimit mbi shkaqet dhe përhapjen e shëndetit të lig.

Spitali Universitar MAS është poashtu anëtar i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, WHO:s , rrjetit ”Të spitaleve përkrahëse të shëndetit”.

## **Bashkëpunëtorët tanë**

Një bashkëpunim i mirë është udhërrëfim për arritjen e suksesit. Për ta zhvilluar dhe përmirësuar mjekësinë si dhe veprimtarinë tonë, lidhim kontakte me partner të jashtëm. Universiteti i Lundit, Shkolla e Lartë e Malmös, Spitali Universitar në Lund, Spitali shtetëror në Kopenhagë, janë vetëm disa nga partnerët tanë me të cilët bashkëpunojmë. UMAS i përket, poashtu, organizatës së rrjetit ndërkombëtar Medicon Valley, që është qendra më e madhe në Skandinavi, dhe njëra nga më të fortat në Evropë, për zhvillim të barnave dhe bioteknikës.